



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 375/3 Prot

Tiranë, më 13.5.2016

VENDIM

Nr. 18, datë 13.5.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit, Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" Tiranë, me aktivitetin e tij në formën ligjore, person juridik,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr.65, datë 18.03.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 16.04.2016 e në vazhdim, pranë kontrolluesit si më lart cituar filloi procedura e hetimit administrativ, me objekt kontrolli:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" Tiranë, i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, nga grupi i inspektimit është konstatuar:

1. Kontrolluesi nuk ka parashikuar në kontratën me punëmarrësit, Deklaratën e Konfidencialitetit, sipas Vendimit Nr.6 datë 05.08.2013, ku numri i punëmarrësve të kontrolluesit që aksesojnë të dhëna personale në forma të ndryshme, është i konsiderueshëm. Ky konstatim nga verifikimi që ju bë dosjeve origjinale të punëmarrësve, mjek dhe infermier.
2. Kontrolluesi si një kontrollues potencial në kuptim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, nuk ka një rregullore të mirëfilltë (përveç dy paragrafeve në Kodin e Etikës), mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

Faktet e mësipërme, përbëjnë shkelje administrative të neneve 27, 28 si dhe akteve të Komisionerit, Vendimit Nr.6, datë 05.08.2013 dhe Udhëzimit Nr.19 datë 03.08.2012.

Në cilësinë provës materiale, këtij procesverballi i bashkëngjiten këto dokumente:

- a-Kontratë me punëmarrësin.
- b-Kontratë shërbimi.
- c-Rregullore bazë e funksionimit të S.U-së.
- d-Pamje nga ambjentet e kontrolluesit.
- f-Kod Etike.
- g-Formular Njoftimi.

Në datë 22.04.2016, u mbajt proces verbali i konstatimit të shkeljeve për kontrolluesin S.U. "Shefqet Ndroqi" Tiranë, ndërmjet grupit të inspektimit dhe përfaqësuesit të kontrolluesit, i cili nuk shprehu pretendime me shkrim, pasi do i paraqiste ato në seancën dëgjimore.

Në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, përpara marrjes së vendimit përfundimtar në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në datë 09.05.2016, është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët paraqitën me shkrim observacionin, me Nr.291/6 Prot., datë 06.05.2016, i cili vijon:

1. *Institucioni ynë nuk ka patur dijeni për miratimin e rregullores së veçantë "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi nuk ka patur asnjë shkresë të mëparshme nga ju si i institucion dhe nuk janë bërë as trajnime për këtë temë.*
2. *S.U. "Shefqet Ndroqi, ka hartuar "Rregulloren për Mbrojtjen, Përpunimin, Rujatjen dhe Sigurinë e të dhënave personale", më datë 04.05.2016, si dhe është urdhëruar zbatimi i saj me urdhër të brendshëm.*
3. *Për sa i përket zbatimit të vendosjes së Deklaratës së Konfidencialitetit pas secilës kontratë me punonjësit e institucionit tonë, ju bëjmë me dije se pas shkresës tuaj janë marrë të gjitha masat për zbatimin e këtij kriteri, si rrjedhim, institucioni ynë është në proces vendosjeje të Deklaratës.*
4. *Njëkohësisht, institucioni ynë në kuadër të Procesit të Akreditimit ka hartuar Rregullore të Brendshme për secilin sektor të tij, për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Informacionit, e miratuar në Maj të 2015.*

Në lidhje me pretendimet e kontrolluesit, Komisioneri bën me dije se:

1-Për sa i përket pretendimit të parë, duke ju referuar aktivitetit të Zyrës së Komisionerit në raport me kontrolluesit, konstatohet se me shkresën Nr.482 Prot., datë 17.05.2010, ju është drejtuar shkresa sensibilizuese, që ju bën me dije Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" si dhe detyrimin që ka çdo kontrollues për të plotësuar Formularin e Njoftimit. Pas kësaj shkrese sensibilizuese, institucioni tuaj, në cilësinë e kontrolluesit ka plotësuar formularin e njoftimit, sipas të cilit, në rubrikën 10.1 "Masat e sigurisë dhe politikat e privatësisë së të dhënave personale" figuron të mos jetë përditësuar, ka ende alternativën "JO", në lidhje me rregulloren e brendshme që flet për mbrojtjen e të dhënave personale. Për pasojë, nga ana e institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe

Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është krijuar komunikimi zyrtar që prej mesit të vitit 2010, ndërsa ligji për mbrojtjen e të dhënave personale ka hyrë në fuqi në vitin 2008.

2-Për sa i përket pikave 2, 3, dhe 4 të observacionit, Komisioneri vlerëson faktin e reagimit në marrjen e masave mbi përmbushjen e gjetjeve të konstatuara nga grupi i inspektimit.

Konstatimet e gjetura konsiderohen në shkelje dhe mosrespektim të kushteve dhe kritereve që parashikon Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, duke patur parasysh faktin që, kontrolluesi ka një periudhë të gjatë kohore që operon në mënyrë të paligjshme në përpunimin e të dhënave personale subjekteve të të dhënave, kryesisht pacientë.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 gërma "dh" të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.

Kontrolluesi, Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" Tiranë, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dylfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, pasi konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave/pacientë.

Komisioneri gjithashtu, ka parasysh faktin që kontrolluesi, ka bashkëpunuar dhe reaguar në rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 27, 28, 30, 31, 39/1, 39/2, gërma "dh", si dhe neneve 40 dhe 41 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit, Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" Tiranë, me gjobë, në vlerën **100 000 (njëqind mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit, Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" Tiranë, me gjobë, në vlerën **100 000 (njëqind mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

3. Kontrolluesi, Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" Tiranë, të realizojë pajisjen e kontratave të punëmarrësve me Deklaratat e Konfidencialitetit sipas Vendimit Nr.6, datë 05.08.2013, brenda një periudhe prej 30 ditësh.
4. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot në, 13.5.2016

